

Ky projekti i financuar nga Bashkimi Evropian ka për synim të sigurojë ndihmë teknike aktorëve kryesorë të cilët marrin pjesë në zbatimin e lëvizjes së lirë të mallrave, në veçanti ato që lidhen me sigurinë e produkteve dhe Infrastrukturën e cilësisë.

Projekti do t'i ndihmojë organeve kombëtare të Infrastrukturës së Cilësisë për Standardizim dhe Akreditim që t'i bashkohen organizatave relevante Evropiane dhe Ndërkombëtare dhe të kompletojnë portofolin e tyre të shërbimeve. Ekipi Ndhmues Teknik do të mbështet Agjencinë Metrologjike të Kosovës (AMK) për rritjen e kapaciteteve të tyre në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tyre aktuale dhe të ekonomisë vendore në metrologjinë industriale dhe ligjore.

Globalizimi i ekonomisë ndërkombëtare dhe sensibilizimi i rritur i konsumatorëve i kanë shtuar një shprehje të re botës së Infrastrukturës së Cilësisë. Kjo shprehje lidhet me fushën e metrologjisë, standardizimit dhe akreditimit po ashtu dhe me vlerësimin e përshtatshmërisë, përfshi certifikimin. Mbështetja e Infrastrukturës së Cilësisë dhe lëvizjes së lirë të mallrave është në thelb të projektit. Në përgjithësi, ndihma do të transferohet përmes dhënies së mbështetjes eksperte në angazhimin dhe përforcimin e legjislacionit të Kosovës dhe praktikave të lëvizjes së lirë të mallrave përmes parimeve dhe rregullave të vërtetuara të BE-së. Do të sigurojë trajnim të nevojshëm për profesionistë dhe vetëdijësim shumë të nevojshëm për këtë temë për publikun në përgjithësi.

### **Objektivi i përgjithshëm**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i ambientit të biznesit në Kosovë dhe konkurrencës së tyre në tregjet ndërkombëtare duke zvogëluar barrierat e tregtisë.

### **Qëllimi**

Qëllimi i projektit është përmirësimi i Sistemit Infrastrukturor të Cilësisë në Kosovë, duke përfshi kontrollin dhe mbrojtjen e konsumatorit, në vijë me kërkesat e BE.

### **Përfituesit:**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) përfshirë:

- Departamentin për Integritet Evropian dhe koordinim të politikave
- Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit
- Departamentin e Industrisë
- Divizionin e Infrastrukturës së Cilësisë i Departamentit të Industrisë
- Agjencinë për Standardizim të Kosovës
- Drejtorinë për Akreditim të Kosovës
- Agjencinë Metrologjike të Kosovës
- Inspektoratin e tregut

Projekti ka filluar më 7 tetor 2014 dhe zgjat 24 muaj.

### **Rezultatet e pritura**

- 1) Procedura e vlerësimit të përshtatshmërisë miratohet në pajtim me kërkesat e direktivave të BE.
- 2) Standardet e BE miratohen në zonat e tregut të cilave u mungon standardizimi.
- 3) Më shumë organe të akredituara të vlerësimit të përshtatshmërisë të veprojnë në tregun vendor.
- 4) Laboratorë modernë dhe funksionalë të Metrologjisë në vend që përdoren nga staf i trajnuar siç duhet.
- 5) Vetëdije e rritur e rëndësisë së standardeve, akreditimeve dhe metrologjisë në mesin e prodhuesve Kosovar.
- 6) Mbrojtja e konsumatorit është më mirë e organizuar dhe e trajnuar.
- 7) Kontrolli i tregut në të gjitha nivelet në pajtim me praktikat më të mira të shteteve anëtare të BE.
- 8) Të dhëna funksionale për prodhime (të rrezikshme) janë duke qarkulluar në tregun vendor.
- 9) Më shumë organe kombëtare për metrologji, akreditim dhe standarde të integruara ndërkombëtarisht.